

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 2

Kodi: 008

HAP PAS HAPI

Trajnimi fillestar për edukatorë që punojnë me fëmijë të moshave 3-6 vjeç

Tipi i programit: Themelor

Hyrje

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) që nga viti 2002 ka ofruar pakon e programeve Hap pas Hapi. Deri më tani një numër i madh i edukatorëve dhe mësimdhënësve janë përfshirë në këtë program, që qëllimin kryesor e ka mësimdhënien me fëmijën në qendër. Programet e trajnimit Hap pas Hapi janë zhvilluar për të kontribuar në edukimin në fëmijërinë e hershme dhe ofrohen për grupmosha, respektivisht klasa të ndryshme. Qasja Hap pas Hapi e trajton klasën si një komunitet të të nxënësve, ku nxënësit angazhohen në mënyrë aktive në procesin mësimor, bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, marrin përgjegjësi për të nxënësit e tyre dhe zhvillojnë aftësi akademike, sociale dhe emocionale. Në këtë mënyrë, mësimdhënësit aftësohen të krijojnë mjedise mësimore që mbështesin pjesëmarrjen aktive, respektimin e diversitetit dhe zhvillimin e plotë të çdo nxënësi.

Hartues i moduleve të trajnimit është OSF - Fondacioni për Shoqëri të Hapur si dhe Universiteti Georgetown në Washington DC. Në Kosovë këto programe fillimisht janë ofruar nga KFOS - Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, ndërsa nga viti 2002 licenca për përdorimin e programit Hap pas Hapi i është transferuar KEC-it.

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:

- Njohjen e *koncepteve* të përgjithshme *filozofike* dhe bazën teorike të *programit me fëmijën në qendër*;
- Njohjen e *praktikave të përshtatshme zhvillimore* që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si genie intelektuale, sociale dhe emocionale;
- Aftësi për organizimin e *mësimit të individualizuar*, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor;
- Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë *frymën demokratike në klasë*;
- Aftësi për *organizimin e mësimit bashkëpunues* që nxit bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm;
- Aftësi për *planifikimin e mësimit tematik* me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies;
- Shkathtësi për *vëzhgimin e fëmijës dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë*;
- Aftësi për *aplikimin e teknikave të përshtatshme të mësimdhënies* në procesin e përvetësimit të njohurive nga përmbajtjet e ndryshme programore;

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 2 nga 2

- Ide për krijimin e një *ambienti stimulus për mësimnxënie aktive*;
- Njohuri për *përfshirjen e familjes* në realizimin e programit.

Përmbajtja e trajnimit

Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm i metodologjisë me fëmijën në qendër, individualizimi, rregullimi i klasës me fëmijën në qendër, materialet në klasë, të mësuarit përmes lojës, roli i edukatorit në klasë me fëmijën në qendër, planifikimi global, planifikimi mujor-javor, planifikimi ditor, dita e balancuar, takimi i mëngjesit, vëzhgimi, dokumentimi, vlerësimi, puna ekipore, përfshirja e familjes, përdorimi i materialeve recikluese, qendrat e aktiviteteve (matematika, blloqet, shkenca, lexim-shkrimi, arti figurativ, familja-dramatizimi, rëra dhe uji).

Grupi i synuar

Ky program u dedikohet edukatorëve të cilët punojnë me fëmijë të moshave 3-6 vjeç, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve dhe studentëve të Universitetit, si dhe trajnerëve të programit.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Trajnimi fillestar për edukatorë realizohet me anë të një trajnimi 5-ditor dhe punës praktike në klasë që përfshin gjithsej 40 orë. Nga 40 orë trajnimi, 30 orë do të organizohen përmes trajnimit të drejtpërdrejt, ndërsa 10 orë do të jenë detyra / punë praktike të cilat do të zbatohen në klasë. Me qëllim që puna të përcillet puna në vazhdimësi dhe të punohet sa më shumë në ngritje të cilësisë së punës parashihen monitorime në klasë, kur mundësohet realizimi i tyre.

Certifikimi

Pjesëmarrësit certifikohen gjithsej për 40 orë (30 orë trajnimi si dhe 10 orë zhvillimi përmes punës në shkollë).

Kriteret për certifikim janë:

- Pjesëmarrja aktive në trajnim, së paku në 90% të kohëzgjatjes së trajnimit; dhe
- Dokumentimi i punës praktike në klasë:
 - Dëshmi të përmbushjes së obligimeve në klasë, ku pjesëmarrësit obligohen të dërgojnë planet e punës dhe dëshmitë e rregullimit të ambientit sipas qendrave mësimore, të cilat realizohen brenda 3 javëve pas përfundimit të trajnimit.